



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Nr: 07/206

Datë: 02.08.2024

Bazuar në Nenin 12. Paragrafi 2 shkronja (d), Nenin 17 shkronja (k), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Nenin 5.4.4, dhe nenin 8.1 të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr.08/L-255, si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi-01/237 të datës 04.07.2024, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale shpall këtë:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

I

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, pranë Komunës së Shtimes, bën thirrje Publike për të gjitha familjet në Komunën e Shtimes që strehojnë fëmijë pa përkujdesje prindërore, që të konkurojnë, për ndarjen e shumës prej 100 € për çdo muaj për vitin 2024.

II

Qëllimi i thirrjes për aplikim është dhënia e mbështetjes financiare për të gjitha familjet e Komunës së Shtimes që kanë strehuar, një ose më shumë fëmijë pa përkujdesje prindërore mbi bazën e kërkesës që do ta paraqet familja në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

III

Kohëzgjatje e pagesës është 6 muaj duke filluar nga 01.07.2024 deri më 21.12.2024.

IV

Dokumentet që kërkohen për paraqitjen e kërkesës janë:

1. Letërnjoftimi kopje vetëm për aplikuesin,
2. Çertifikata e lindjes së fëmiut,
3. Kontrata për strehim familjar të fëmiut, nga Qendra për Punë Sociale,
4. Konfirmimi nga banka të numrit të llogarisë rrjedhëse,

V

Afati dhe procedura e aplikimit:

Afati për dorëzimin e kërkesës është 15 ditë nga dita e shpalljes. Kërkesa me dokumentet e bashkangjitura duhet të dorëzohen në Zyrën Pritese në katin përdhësë (Sportelet e Komunës), çdo ditë pune nga ora 8:00-16.

Informatat më të hollësishme rreth aplikimit mund t'i merrni në Zyrën e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.



U.D. i QKMF - Shtime

Ilaz Kadrija
Ilaz Kadrija